

Kryqi i Kuq i Kosovës Politika e Rinisë

Hyrja

Zotimi i Kryqit të Kuq të Kosovës është parandalimi dhe lehtësimi i vuajtjeve njerëzore, kjo është një detyrë me të cilën të rinjtë identifikohen lehtë. Të rinjtë mund të japin një kontribut të madh në identifikimin e nevojave të njerëzve vulnerabil në shoqërinë e tyre edhe më gjerë.

Rinia përbën një pjesë shumë të rëndësishme të KKK-së. KKK-ja gjithmonë e ka vlerësuar këtë.

Kjo Politikë do t'i ndihmojë shumë Kryqit të Kuq të Kosovës në planifikimin e zhvillimit të programit të rinisë së KKK-së që do të kontribuoj në motivimin dhe idealizmin e rinisë.

Politika e Rinisë përshkruan rolin e secilit partner të përfshirë në KKK duke u siguruar se këto grupe të rëndësishme të njerëzve vlerësohen dhe përkrahen.

Termi "Rini" përfshin moshën prej 5 deri 27 vjeç. Këtu përfshihen: juniorë gjerë në moshën 15 vjeçare, rininë gjerë në moshën 27 vjeçare.

Tradicionalisht, fëmijët dhe adoleshentët kanë qenë përfitues nga aktivitetet e KKK-së. Ata duhet poashtu të kenë mundësinë për t'i shërbyer si vullnetarë KKK-së.

Programi i Rinisë i Kryqit të Kuq të Kosovës

Programi i Rinisë i Kryqit të Kuq të Kosovës ka për qëllim përfshirjen e rinisë në aktivitetet e KKK-së si partner, vullnetarë, punëtor (sipas nevojës) dhe përfitues.

Ky program ndihmon të rinjtë në implementimin e Parimeve Themelore të Lëvizjes përmes:

- Mbrojtjes së shëndetit dhe jetës
- Shërbimit në komunitet
- Shoqërorizimin ndërkombëtar
- Vetinformimin dhe informimin e të tjerëve për rolin dhe përgjegjësitë e KKK-së dhe Lëvizjes në përgjithësi.

Deklaratat e Politikës

Rinia luan rolin kryesor në kryerjen me sukses të shërbimeve që ofron Kryqi i Kuq i Kosovës

Rinia e KKK-së ka kontribuar me vite me forcën më të mirë të mundshme vullnetare në lehtësimin e vuajtjeve njerëzore përmes shërbimeve dhe programeve zhvillimore.

Ata janë në një pozitë ideale për identifikimin e nevojave të të rinjëve dhe pjestarëve tjerë të komunitetit. Ata zhvillojnë dhe implementojnë programe, gjejnë mënyra dhe mjete të reja që t'iu ndihmojnë të rinjëve nevojtarë. Ata në këtë mënyrë i shtojnë besueshmërinë KKK-së në grupe të ndryshme.

Të rinjtë janë një grupcaku i rëndësishëm, qoftë për anëtarësi si dhe për komunitetin e gjerë

Në mënyrë që të ketë sukses në programet e veta KKK duhet të punojë direkt me rini. Pothuaj të gjitha programet e KKK-së kanë si “përfitues” rininë.

Të rinjtë luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen dhe menaxhimin e Lëvizjes së sotme dhe KKK-së poashtu

Kur të rinjtë janë të involvuar plotësisht në marrjen e vendimeve dhe në udhëheqjen e KKK-së, ata sjellin jo vetëm përvojat e tyre, kreativitetin e veçantë dhe idealizmin që e plotëson edhe zhvillimin e anëtarëve tjerë, por ata poashtu avokojnë për nevojat e të rinjëve në shoqëri.

Të rinjtë e së sotmes do të udhëheqin KKK në të ardhmen

Në shumicën e Shoqatave Kombëtare, liderët e së sotmes kanë qenë anëtarët e rinisë së gjeneratave të kaluara. Kur të rinjtë punojnë krah për krah me anëtarët e vjetër në shërbimet e programeve të KKK-së, ata shumë shpejtë i fitojnë njohuritë që iu mundësojnë atyre të udhëheqi KKK në të ardhmen.

Të rinjtë kanë nevojë për përkrahje

Të rinjtë ndonjëhere mund të jenë të kufizuar në shoqëri përshkak të statusit social që kanë. Nëse dëshirojmë që t'iu ofrojmë mundësinë për të realizuar potencialin e tyre në KKK, duhet të zhvillohen programe dhe struktura të ndryshme përkrahëse.

Strategjia

Për të pranuar këtë Politikë secili nga anëtarët e KKK-së ka disa detyra që duhet t'i përmbushë:

1. Rinia do të:

- a. Përhapë njohuri dhe do të ofroj shërbime të KKK-së moshatarëve të vet dhe pjesës tjetër të shoqërisë;
- b. Të rekrutoj anëtarë në KKK;
- c. Të infromojë KKK për nevojat e tyre, interesat dhe mundësitë;
- d. Përmes moshatarëve dhe kontakteve familjare të identifikojë nevojat në vendet ku shërbimet e KKK-së janë të nevojshme;
- e. Të jenë të përgaditur që të marrin përgjegjësi brenda në organizatë.

2. Liderët e Rinisë do të:

- a. Të udhëheqin grupet rinore në KKK;
- b. Ndihmoj të rinjtë në identifikimin e nevojave të tyre dhe të shoqërisë;
- c. Të sigurojnë trajnimet dhe burimet e nevojshme si dhe të motivojnë të rinjtë që t'i plotësojnë këto nevoja;
- d. Inkurajojnë të rinjtë që të marrin rolin udhëheqës në grupet Rinore;
- e. Të shërbejnë si lidhje mes rinisë dhe anëtarëve të tjerë të KKK-së që t'iu mundësojnë atyre të punojnë së bashku;
- f. Raportojnë degën për aktivitetet e tyre.

3. Trajnerët e rinisë do të:

- a. Identifikojnë nevoja për trajnime të të rinjëve;
- b. Janë përgjegjës për trajnimin e rinisë në fusha të ndryshme;
- c. Përcjellin punën e të rinjëve në fushat e trajnuara;
- d. Ruajn kontinuitetin e trajnerëve duke trajnuar të rinj për trajner të rinisë;
- e. Marrin pjesë në krijimin e doracakëve për vullnetarët e rinj në KKK.

4. Përfaqësuesit e Rinisë do të:

- a. Marrin përgjegjësinë dhe iniciativën bashkë me KKK për të zhvilluar ose marrë pjesë në zhvillimin e politikave dhe programeve për anëtarët e rinisë;

5. Kryqi i Kuq i Kosovës

Që t'iu mundësohet rinisë dhe liderëve të tyre që të arrijnë këtë, KKK duhet që:

- a. Të siguroj përkrahje kombëtare për Rini në atë formë që është e përshtatshme për strukturën dhe burimet e KKK-së;
- b. Të punoj me rininë e vet që të krijojnë një Politikë kombëtare të rinisë që do të jetë baza e gjithë punës së saj me të rinjtë e vet;
- c. Bashkë me anëtarët e rinj të analizojnë nevojat dhe potencialin e të rinjëve anëtarë dhe të shoqërisë në përgjithësi, dhe të përdorin këtë informacion për:

- Përfshirjen e të rinjëve në secilin program dhe
- Dizajnimin e programeve edukative dhe trajnuese për rini që ndikojnë në integrimin gradual në KKK;
- Intesifikimi i rekrutimit të anëtarëve të rinj.

- d. Të siguroj se të rinjtë janë të përfshirë në vendimmarrje në çdo nivel të Shoqatës. Kjo mund të arrihet duke i përfshirë ata në struktura si: Komisionin e rinisë në nivel Qendror dhe komunal, duke pasur përfaqësues të rinisë në Kryesitë lokale dhe Qendrore, përfshirja e rinisë në grupet punuese etj.
- e. Implementimi i programeve të trajnimeve për anëtarët e rinisë;
- f. Organizmi i takimeve njoftuese për Politikën dhe Strategjinë me udhëheqësinë dhe menaxhmentin e KKK-së;
- g. Përfshirja e rinisë në punën e përditshme të stafit të KKK-së për këmbimin e shkathtësive dhe njohurive;
- h. Krijimi i kontakteve me Shoqatat tjera si motra më qëllim të këmbimit të burimeve, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe t'iu mundësohet takimi me homologët e tyre nga vendet e tjera, kështu ata do të provojnë me të vërtetë miqësinë ndërkombëtare në shpirtin e Lëvizjes.
- i. Të bëjnë përpjekeje të vazhdueshme që të inkurajojnë vajzat e reja që të marrin role më aktive veçanërisht në pozitave të udhëheqësve.

6. Kosmisioni i Rinisë do të:

- a. Promovoj dhe ndihmoj progresin e implementimit të Politikës së Rinisë në KKK;
- b. Të raportoj në çdo takim të Kryesisë dhe Komisionit të Rinisë për progresin e bërë;
- c. Të kërkoj opinionet e Rinisë nga të gjitha OK-të për implementimin e politikave dhe programeve dhe që këto të mirren parasysh edhe në Statut;
- d. Propozimi i prioriteteve të veçanta të Rinisë duke u mbështetur në përmbajtjen e Politikës së Rinisë.

7. Zyra Kryesore e KKK-së do të:

- a. Të siguroj që çështjet rinore të konsiderohen në mardhënie me secilën fushë operuese dhe programore;
- b. Inkurajimin e zhvillimit të shërbimeve të Rinisë së OK-ve në mardhënie me të gjitha programet tjera;
- c. Të siguroj se programi i Rinisë ka burime të mjaftueshme dhe është i përgaditur për rolin e tij.

8. Programi i Rinisë në nivel Qendror do të:

- a. Të përkrah Rininë e Degëve dhe shërbimet e tyre;
- b. Koordinimin e këmbimeve mes programeve, ideve dhe burimeve mes degëve dhe më gjerë në mënyrë që mos të ketë duplikim të aktiviteteve si dhe të ndihmoj zhvillimin e programeve;

- c. Adaptimin e programeve rinore nga model-programet që kanë të bëjnë me këto çështje;
- d. Organizimi i takimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për inkurajimin e të rinjëve dhe të rriturve që punojnë me të rinjtë që të takohen dhe të këmbëjnë ide dhe përvoja;
- e. Të siguroj përkrahje teknike për degët që organizojnë takime në nivel lokal, qendror apo edhe regjional;
- f. Të bashkëpunoj me programet e tjera të KKK-së për qështjet e rinisë që lidhen me punët e tyre;
- g. Raportim Kosmisionit të Rinisë dhe Kryesisë në nivel Qendror për progresin e implementimit të kësaj politike dhe programit të Rinisë.

9. Bashkëpunimi me Organizatat tjera Rinore

Përmes bashkëpunimit me Organizatat dhe rrjetet tjera Rinore, ne mundemi së bashku të fitojmë njohuri, këmbëjmë ide dhe përvoja si dhe mund të përhapim njohuritë për KK te të rinjtë e tjerë. Bazamenti i çdo bashkëpunimi duhet të jetë qëllimi i përbashkët dhe në përputhje me Parimet e Lëvizjes të Kryqit të Kuq dhe Gjysmhënës së Kuqe

10. Vlerësimi

Për të siguruar kontinuitetin dhe progresin e politikës së Rinisë, duhet të bëhet vlerësim i rregullt në secilin nivel strukturor të KKK-së. Në veçanti Rinia duhet të jetë e përfshirë në këtë proces vlerësimi.

Vlerësimi është përgjegjësi e vet Rinisë, Shoqatës Kombëtare dhe Federatës.